



**KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT**  
**ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE**

---

**RAPORT MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT**  
**NË SHQIPËRI**  
**PËR VITIN 2016**

Tiranë, Prill 2017



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika ligjore X”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga organizata Civil Rights Defenders, me fonde të Qeverisë së Mbretërisë Suedeze.



Kingdom of Sweden



Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Qeverisë Suedeze ose të organizatës Civil Rights Defenders.

Përgatitën:

1. Av. Elton Frashëri, Jurist i Klinikës Ligjore në KShH
2. Av. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e KShH-së
3. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor i KShH-së

Asistoi:

1. Valentina Kabili, Asistente Projektsh në KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor:

©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

**Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”**

**Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania**

**Kutia Postare nr.1752**

**Tel: 04 2233671**

**Cel: 0694075732**

**E-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al);**

**Web site: [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)**



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## **Të dashur lexues,**

Viti 2016 ishte një vit me zhvillime dinamike, ku në mënyrë të veçantë spikatën ndryshimet e ndjeshme në kuadrin ligjor për reformimin e sistemit të drejtësisë. Reforma në drejtësi pritet të rikthejë besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Vëmendja qytetare është fokusuar te Vettingu i gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili do të realizohet në 3 komponentë, vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), si pjesë e shoqërisë civile, ishte aktive në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të shtetasve në përputhje me misionin e tij. KShH veproi në disa prej fushave që janë prioritare në strategjinë e saj tre vjeçare dhe njëkohësisht janë prioritet për hapjen e negociatave për vendin për t'u bërë pjesë e familjes Evropiane.

Për KShH-në, viti 2016 ishte një vit me shumë veprimtari dhe shtrirje, përgjegjësi e sfida të reja, larmishmëri dhe kontribute të prekshme, profesionale dhe të paanshme për qytetarët dhe grupet në nevojë të shoqërisë tonë. Numri i shtetasve që iu drejtua KShH-së përgjatë këtij viti u rrit dhe po ashtu nevoja për të rritur profesionalizmin në trajtimin e ankesave të tyre. Vetëm përgjatë këtij viti, KShH ju drejtua Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me 4 kërkesa, duke kërkuar rivendosjen e të drejtave të shkelura që janë parashikuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

KShH ka qenë i pranishëm në qytete të ndryshme të vendit, duke përçuar zërin reagues dhe ndërgjegjësues në mbarë opinionin publik. Falenderojmë median e shkruar dhe audiovizive që i dha jehonë veprimtarive me rëndësi të KShH-së për të drejtat dhe liritë e shtetasve dhe për forcimin e shtetit të së drejtës.

Veprimtaria e KShH-së nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e antarëve të organeve të saj drejtuese, Asamblesë së Përgjithshme dhe Bordit vendimmarrës, stafit të organizatës, korrespondentëve në 7 rrethe të vendit, aktivistëve dhe vullnetarëve tanë, vëzhguesve dhe ekspertëve që kanë kontribuar me përkushtim dhe aktivizëm të lartë, me ekspertizë të paanshme dhe profesionale.

Gjithashtu, falenderojmë donatorët që kanë mbështetur financiarisht veprimtarinë e KShH-së përgjatë këtij viti, të cilët na kanë besuar për zbatimin me seriozitet, ndershmëri dhe përgjegjshmëri të nismave të ndryshme aktuale në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut, përkatësisht Civil Rights Defenders, Bashkimin Evropian, Ambasadën e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri, Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Programin e USAID "Drejtësi për të Gjithë", Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, Institutin e të Drejtave të Njeriut në Budapest, etj.

Sinqerisht,

**Erida Skëndaj**



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## 1. HYRJE

Situata e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri monitorohet dhe raportohet në vazhdimësi, nga organizma vendas dhe ndërkombëtarë, duke vlerësuar njëkohësisht edhe nivelin e zhvillimit të vendit në drejtim të funksionimit të shtetit të së drejtës dhe ecurinë e integritetit të tij në familjen evropiane.

KShH vazhdon prej disa vitesh traditën, në përgatitjen e Raportit vjetor mbi respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri. Raporti përmban fakte dhe konkluzione rreth situatës së respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut për vitin 2016<sup>1</sup> dhe ka për qëllim të adresojë problematikat, të informojë publikun e gjerë, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare të akredituara në vendin tonë, të nxisë organet e pushtetit publik për respektimin e kuadrit ligjor dhe përmirësimin e veprimtarisë së tyre për një mbrojtje dhe garantim efektiv të të drejtave të shtetasve.

Gjetjet dhe konstatimet që kanë rezultuar nga verifikimet e ankesave dhe vëzhgimet tematike që ka kryer KShH, kryesisht në gjykata dhe prokurori, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, mjediset e Policisë së Shtetit, organet e qeverisjes në nivel qendror dhe vendor, kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij raporti. Gjithashtu, informacioni i pasqyruar në media për rastet e shkeljes së të drejtave dhe lirive të shtetasve apo ngjarje që mund të ndikojnë në gëzimin dhe ushtrimin e këtyre të drejtave, si dhe raportet apo studimet e organizatave të tjera të shoqërisë civile vendase dhe organizmave ndërkombëtarë janë pasqyruar në këtë raport.

Gjatë vitit 2016, KShH ka trajtuar 290 ankesa nga shtetas që pretendonin cenimin e të drejtave, i është drejtuar në 325 raste institucioneve shtetërore duke adresuar rekomandime apo duke i vënë në dijeni për problematikat e evidentuara nga veprimtaria monitoruese e KShH-së, si dhe ka reaguar publikisht me deklaratat për shtyp në 46 raste. KShH ka realizuar 188 verifikime, duke përfshirë monitorim në burgje, paraburgime e komisarate policie, prokurori, Polici Bashkiake, QSUT, institucione të tjera të administratës publike, verifikime në terren si dhe janë realizuar 16 monitorime të seancave gjyqësore, etj. Për rivendosjen e të drejtave të shkelura, KShH i është drejtuar organeve përkatëse shtetërore, gjykatave të brendshme, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj).

KShH gjatë vitit 2016 ka dhënë oponencë ligjore për 7 projektligjet organike të sistemit të drejtësisë dhe 9 projektligje të tjera që janë shqyrtuar nga komisione të ndryshme parlamentare. Gjithashtu, kemi dhënë mendime lidhur me mënyrën e raportimit vjetor në Kuvend, të institucioneve kushtetuese apo ligjore, si Avokati i Popullit dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit. Në vlerësimet e paraqitura për raportimet vjetore të këtyre institucioneve i është kushtuar vëmendje e veçantë dhënies së mendimit kritik dhe konstruktiv për një mbrojtje më të mirë të të drejtave dhe lirive të shtetasve.

KShH ka kontribuar gjithashtu në drejtim të edukimit ligjor dhe sensibilizimit të shtetasve, duke u ndalur në mënyrë të veçantë te risitë që sjell reforma në sistemin e drejtësisë dhe ligji për njoftimin dhe konsultimin publik. Ndërgjegjësimi i shtetasve dhe transparenca ndaj publikut janë tregues të rëndësishëm të zhvillimit të demokracisë.

---

<sup>1</sup> Gjetjet kanë rezultuar nga informacioni i siguruar deri në fund të muajit Dhjetor 2016



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## 2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KShH ka reguar në mënyrë të vazhdueshme për kushtet dhe trajtimin e personave të privuar nga liria në sistemin e burgjeve, rastet e cenimit të sigurisë të të dënuarve dhe të paraburgosurve në këtë sistem, rastet e dhunës ndaj gruas dhe fëmijëve, për nevojën dhe rëndësinë që ka për qytetarët reformimi i sistemit të drejtësisë dhe reforma zgjedhore, për marrjen e masave efektive parandaluese kundër kriminalitetit, etj.

Mbipopullimi në burgje dhe veçanërisht në paraburgim është shqetësues, ndërkohë që masa e sigurisë arrest në burg mendojmë se mund të zbatohet në masë më të reduktuar. Kushtet e dhomave ku mbahen personat e privuar nga liria në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, Lushnje, Rrogozhinë, Fushë – Krujë dhe Fier nuk mundësojnë respektim të plotë të dinjitetit njerëzor si rezultat i mbipopullimit, mungesës së krevatave, kompleteve të përshtatshme të fjetjes, mjeteve të higjienës, etj. Në Institucionin e veçantë në Zahari të Krujës kushtet janë në nivelin e trajtimit çnjerëzor dhe degradues. KShH i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse mbylljen e këtij institucioni.

Më shumë se 64% e ankesave drejtuar KShH-së vijnë nga shtetasit e paraburgosur dhe të dënuar, të cilët ankohen për kushtet e papërshtatshme dhe shkelje të të drejtave të këtyre shtetasve nga administrata e burgjeve. 21% e ankesave, i adresohen shkeljeve të të drejtave të individit nga veprimtaria e organeve të drejtësisë, por sidomos nga gjykatat. Kryesisht qytetarët ankohen për vendime të padrejta gjyqësore kryesisht për shkak të korrupsionit, cenim të procesit të rregullt ligjor, zvarritje të procesit gjyqësor apo ankesë për mospërfitim nga ulja e dënimit apo lirimi me kusht, mosekzekutim i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet shtetërore, etj.

Në disa raste, KShH ka përfaqësuar shtetas në gjykatat vendase dhe ndërkombëtare. Në periudhën maj - korrik 2016, KShH i është drejtuar me 4 ankesa Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) me autorizimin e individit, në lidhje me respektimin e të drejtës së shtetasve për akses në drejtësi, të së drejtës për zhvillimin e një procesi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, të së drejtës për ndalimin e torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, ndalimin e diskriminimit, etj.

Akomodimi në sistemin e burgjeve i rreth 175 të sëmurëve mendorë me masë mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, përbën shkelje të rëndë të të drejtave të tyre si dhe ka sjellë përkeqësim të gjendjes së shëndetit të tyre mendor. Një nga çështjet që po përfaqësojmë në Gjykatën e Strasburgut synon zgjidhjen e këtij problemi endemik që shteti shqiptar nuk ka mundur t’i japë zgjidhje efektive prej gati 20 vitesh.

Qytetarët përballen me rastet e mjekimit të pakujdesshëm, dëmtimet në shëndet dhe humbjen e jetës në aksidente rrugore, të cilat shkaktohen në disa raste edhe për shkak të mungesës së sinjalistikës dhe infrastrukturës së papërshtatshme të rrugëve, përballen gjithashtu me krimet kundër jetës, probleme strukturore që vazhdojnë të prekin sistemin e shëndetit publik si mungesa e ilaçeve apo e infrastrukturës mjekësore. Reagimet e KShH-së dhe Together for Life për mungesën e medikamentit L-Asparaginase për fëmijët me leuçemi, kontribuan në reagimin pozitiv të Ministrisë së Shëndetësisë për sigurimin e këtij preparati.



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nevojitet rritja e masave për ndalimin e diskriminimit dhe integrimin e grupeve të marginalizuara të shoqërisë. Shtetas të Komunitetit rom dhe egjiptian që banojnë në bashkitë Tiranë, Durrës, Fier, Berat, Shkodër dhe Krujë nuk kanë informacionin minimal për të drejtat dhe mjetet e kërkimit të tyre. Një pjesë e fëmijëve Rom nuk ndjekin arsimin e detyrueshëm ose e braktisin atë. Një numër i konsiderueshëm personash në radhët e këtyre komuniteteve grumbullojnë mbetjet urbane si e vetmja mundësi për të fituar të ardhura. Mundësitë e punësimit dhe të formimit profesional për këta shtetas janë të pakta. Programet sociale të strehimit të ofruara për familjet në nevojë të Komunitetit rom, të cilëve u është prishur banesa e palegalizuar, për interes publik, nuk kanë garantuar efektivisht dhe në mënyrë të qëndrueshme jetesën e qetë familjare. Mungesa e përcaktimit të minimumit jetik me akte ligjore e nënligjore ka ndikuar në uljen e cilësisë së jetesës së këtyre komuniteteve si dhe ka shmangur marrjen e përgjegjësisë të plota nga ana e shtetit për ofrimin e ndihmës së mjaftueshme për familjet në nevojë.

Miratimi i Planit të Veprimit për personat me orientim të ndryshëm seksual përbën një hap pozitiv. Megjithatë, ndërgjegjësimi i publikut për pranimin e këtyre personave në shoqëri mbetet në nivele të ulëta, duke përfshirë edhe prezencën e sjelljeve diskriminuese nga nëpunës publikë ndaj anëtarëve të Komunitetit LGBTI.

Monitorimet e kryera në sistemin gjyqësor evidentojnë se vijon të mbetet problem pandëshkueshmëria e zyrtarëve të nivelit të lartë për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës. Respektimi i të drejtës për proces të rregullt dhe cilësia e ofrimit të drejtësisë nuk ka pësuar progres për shkak të keqadministrimit, mungesës së aksesit në drejtësi, ankesave në drejtim të mungesës së integritetit profesional të disa gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe perceptimit për korrupsionin e përhapur në organet e drejtësisë. Në procese gjyqësore të monitoruara nga KShH rezultojnë se avokatët e caktuar kryesisht nga gjykata dhe prokuroria, shpesh e kryejnë detyrën e mbrojtësit formalisht dhe është vërejtur mungesë profesionalizmi. Në mënyrë të veçantë, të paraburgosurit dhe të dënuarit ankohen për cilësinë e dobët të mbrojtjes së këtyre avokatëve. Ngritja e institucioneve të vettingut në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin përbën hapin më të rëndësishëm për qytetarët të cilët kërkojnë të rifitojnë besimin në organet e sistemit të drejtësisë.

Të dhënat zyrtare evidentojnë përhapje të gjerë të fenomenit të dhunës në familje, veçanërisht ndaj gruas. Gjithashtu dhuna ndaj fëmijëve gjatë vitit 2016 ka qenë shqetësuese, veçanërisht në qendrat rezidenciale për fëmijët, në sistemin parashkollor dhe në ciklin e ulët mësimor. Koordinimi mes institucioneve përgjegjëse për referimin dhe trajtimin e këtyre rasteve si dhe mbrojtja gjyqësore nuk ka rezultuar gjithmonë efektive.

Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të policisë së shtetit, gjendja e kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike ka qenë shqetësuese gjatë vitit 2016. Shqipëria vazhdon të jetë sipas analistëve të sigurisë një vend i origjinës së kultivimit të marijuanës, i cili vit pas viti prodhon një zinxhir efektshëm kriminal. Ky fenomen kërkon intensifikim të operacioneve anti narkotikë në mbarë vendin dhe koordinim më të mirë mes policisë së shtetit dhe prokurorisë. Zbatimi i një politike penale bashkëkohore që t'i përgjigjet formave të ndryshme të kriminalitetit, përfshirë ato të sofistikuara dhe krimet të organizuar, duke respektuar proporcionalitetin e masave në funksion të humanizimit të së drejtës penale vijon të mbetet nevojë, e cila nuk u adresua efektivisht gjatë vitit 2016.





# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KShH-ja vazhdon sensibilizimin e grupeve të interesit dhe monitorimin e zbatimit të një ligji të rëndësishëm që parashikon detyrimin e organeve publike, për njoftimin dhe konsultimin publik për projektakte, projektstrategji dhe politika të ndryshme me interes publik. Nga monitorimi i ushtruar në 20 institucione qendrore (19 Ministri dhe Institucioni i Kryeministrit), rezulton se konsultimi i projektakteve nuk realizohet në përputhje me procedurat dhe afatet si dhe në disa raste ka karakter formal. Në të shumtën e rasteve projektligjet konsultohen nga ekzekutivi dhe legjislativi në afate tepër të ngushta dhe grupet e interesit nuk njihen me rekomandimet që janë marrë në konsideratë si dhe përmbledhjen e arsyeve të refuzimit për ato rekomandime që nuk janë pranuar. Në ndryshim nga ligji për të drejtën e informimit, ligji për njoftimin dhe konsultimin publik është zbatuar me hapa të ngadaltë.

KShH ka ndjekur edhe përgatitjet për zgjedhjet parlamentare të vitit 2017. Në prill të 2016-ë s i paraqitëm Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore 32 propozime për ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Vonesat dhe mungesa e konsensusit të plotë mes palëve për të reflektuar në kohë të gjitha rekomandimet e OSBE/ODIHR-it ishin tregues që përpjekjet për të realizuar reformën zgjedhore gjatë vitit 2016, nuk u orientuan nga kërkesa qytetare për përmbushjen e standarteve ligjore për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Mediat në përgjithësi mbeten të ndikuara nga politika, interesat politiko-ekonomike të pronarëve të tyre dhe kushtet e kontraktimit dhe punësimit të gazetarëve nuk rezultojnë në çdo rast në përputhje me ligjin. Ankesa e gazetares së pushuar nga puna në një televizion privat, për investigimin e kryer për rrethanat e vdekjes së të miturit në Landfillin e Sharrës, si dhe censurimi i transmetimit të kësaj videoje çoi në reagimin tonë se gazetaria investigative ka nevojë për më shumë mbrojtje dhe inkurajim dhe se gazetaria serioze nuk mund të ekzistojë pa burimet e informacionit.

Pavarësisht se nuk ka patur incidente me mbrojtësit e të drejtave të njeriut, vërehet se mjedisi në të cilin punojnë dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre shumë organizata jofitimprurëse në disa raste synon të frenojë veprimtarinë e këtyre organizatave. Deklaratat e bëra në disa raste kundër veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile, vlerësojmë se ndikojnë në mënyrë të padrejtë në uljen e besimit të publikut tek shoqëria civile si dhe synojnë të zhvendosin apo minimizojnë vëmendjen nga kauzat që mbrohen prej saj nëpërmjet protestave, tubimeve paqësore apo veprimtarive të tjera publike.

Dëmtimi i pyjeve, si pasojë e prerjes së pemëve pa kriter, shfrytëzimi i inerteve të lumenjve, duke dëmtuar rrjedhën e tyre natyrore, hedhja e mbetjeve të ndërtimit buzë ujrave natyrore si, lumenj e liqene, lëshimi i gazrave ndotës në ajër dhe veprime të tjera abuzive, kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në mjedis. Organet përgjegjëse të pushtetit publik, në nivel qendror dhe vendor nuk ka mundur të reagojë mjaftueshëm për t'i parandaluar këto veprime. Gjithashtu, organet e sistemit të drejtësisë penale vlerësojmë se nuk kanë qenë efektive në drejtim të vënies para përgjegjësisë penale të autorëve të veprave penale në fushën e mjedisit.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## 3. GJETJET KRYESORE

### 3.1 E drejta e jetës dhe shëndeti

E drejta e jetës është e drejtë themelore dhe kusht për të gëzuar dhe ushtruar efektivisht çdo liri apo të drejte njerëzore<sup>2</sup>. Shteti ka detyrimin për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve duke u ndalur në mënyrë të veçantë në ruajtjen e rendit publik dhe sigurisë së shtetasve, mbrojtjen nga aksidentet rrugore, ofrimin e shërbimeve të përshtatshme të kujdesit shëndetësor, ofrimin e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm, etj.

Zbatimi i një politike penale bashkëkohore që t'i përgjigjet formave të ndryshme të kriminalitetit, përfshirë ato të sofistikuara dhe krimet të organizuar, duke respektuar proporcionalitetin e masave në funksion të humanizmit të së drejtës penale vijon të mbetet nevojë, e cila nuk u adresua efektivisht gjatë vitit 2016.

Ankesat e shtetasve të publikuara në media apo drejtuar KShH-së gjatë vitit 2016 janë tregues se ata përballen me probleme serioze në respektimin e të drejtës së jetës, si: mjekim i pakujdesshëm apo i papërshtatshëm, aksidente automobilistike si pasojë e problemeve infrastrukturore, drejtimi i mjeteve motorike në gjendje të dehur apo mungesa e sinjalistikës në rrugë, për të cilën sipas INSTAT rezultojnë rritje 12.7 % lidhur me 6-mujorin e parë të vitit krahasuar me vitin e kaluar; vrasje ose plagosje me armë zjarri, brenda familjes apo të lidhura me veprimtarinë e organizatave kriminale, për të cilat organizata SAS (Small Arms Survey) e rendit Shqipërinë të dytën në Evropë; trafikimin e qenieve njerëzore, ku sipas Raportit të Komisionit Evropian, Shqipëria është një ndër 5 vendet jo-antare të BE-së me numrin më të lartë të viktimave të trafikimit njerëzor të regjistruara, ndërkohë që vendimet e formës së prerë për rastet e trafikimit njerëzor janë rritur gjatë viteve të fundit; mungesa e shërbimit shëndetësor në sistemin penitenciar; probleme strukturore që vazhdojnë të prekin sistemin e shëndetësisë si mungesa e ilaçeve apo e mjeteve/infrastrukturës mjekësore, etj.

Pavarësisht investimeve publike të realizuara gjatë vitit 2016 në ofrimin e kujdesit shëndetësor në disa spitale rajonale si psh. në Elbasan, Shkodër, Tiranë, etj., në shërbimin ortopedik, onkologjik, urgjencë, etj., ka ende mungesa serioze në garantimin e një shërbimi profesional cilësor, veçanërisht në drejtim të modernizimit të pajisjeve dhe infrastrukturës mjekësore. Në këtë drejtim mendojmë se ka ndikuar negativisht edhe fenomeni i korrupsionit të *bluzave të bardha*, i perceptuar gjerësisht nga shoqëria shqiptare.

Në media është raportuar vazhdimisht edhe gjatë këtij viti, për spitale dhe klinika të kujdesit shëndetësor publik në kushte infrastrukturore krejtësisht të papërshtatshme. Në qendrat spitalore ka raste të mungesës së aparaturave, si psh, Implanti Koklear që mundëson dëgjimin tek fëmijët, mjeteve specifike ortopedike apo mungesë të barnave, duke detyruar shtetasit t'i sigurojnë ato privatisht. Nuk kanë munguar rastet e shqetësimeve të adresuara nga shtetasit për mungesën e ngrohjes së nevojshme në spitale publike, përfshirë spitalin e Korçës të verifikuar

---

<sup>2</sup> Neni 15 i Kushtetutës: “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre*”.





# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

nga KShH<sup>3</sup> në shërbimin e sanatoriumit, pavarësisht specifikës së sëmundjeve që trajtohen nga ky shërbim.

Gjatë vitit 2016, KShH ka trajtuar rastin e një fëmije 11-vjeçar, të diagnostikuar me sëmundjen e rëndë Tumor malinj të këllëfit nervor periferik. Në vazhdimësi, ai ishte trajtuar dhe ndjekur nga Shërbimi i Onko-Hematologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT), ku nuk kishte mundur të mjekohet sipas protokollit përkatës mjekësor për shkak të mungesës së medikamenteve nga shërbimi spitalor publik, duke e siguruar një pjesë të kurës me të ardhurat personale, pavarësisht kostos së lartë financiare.

KShH në bashkëpunim me organizatën Together for Life, me anë të një kërkesë vuri në lëvizje Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) me objekt konstatimin e diskriminimit të tërthortë nga QSUT, për shkak të mungesës së ilaçit L-Asparaginaze për fëmijët e sëmurë me leuçemi. Në dhjetor 2016, KMD pranoi kërkesën e KShH-së duke konstatuar diskriminim të tërthortë dhe rekomandoi marrjen e masave nga QSUT furnizimin me medikamentin L – Asparaginaze në sasinë dhe në kohën e duhur.

Gjithashtu, KShH ka ndjekur edhe raste të tjera duke reaguar nëpërmjet shkresave zyrtare drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, ku përcillen shqetësimet për mungesën e mjeteve mjekësore të dëgjimit për të miturit. Në muajin maj 2016, KShH paraqiti një kërkesë për informim tek Ministria e Shëndetësisë, lidhur me pretendimet e botuara në median e shkruar se, një numër i konsiderueshëm i fëmijëve rrezikoheshin të mbeteshin me paaftësi të plotë dëgjimore për shkak të mos-sigurimit të pajisjes së dëgjimit, implantit koklear. Me qëllim mbrojtjen e shëndetit të këtij grupi vulnerabël, KShH së bashku me Together for Life ka vazhduar ndjekjen ligjore të çështjes tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për të mundësuar informacionin e nevojshëm mbi problemin e mungesës së pajisjes mjekësore.

Gjithashtu, ***dhuna në familje*** vijon të mbetet shqetësuese për shtrirjen e saj në shoqëri. Gratë, fëmijët e mitur, të moshuarit apo shtesa të marxhinalizuara brenda familjes janë viktimat më të shpeshta të këtij fenomeni. Ushtrimi i dhunës ndaj grave paraqitet ende mjaft shqetësues, ku në disa raste viktimës i është shkaktuar si pasojë vdekja. Shpesh, gratë e dhunuara nuk denoncojnë pranë organeve kompetente dhunën e ushtruar ndaj tyre, apo tërheqin kallëzimin e bërë, për shkak të pamjaftueshmërisë ekonomike për të përballuar jetesën apo për shkak të mentalitetit shoqëror.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për periudhën janar-shtator 2016, janë raportuar 3195 raste dhune në familje, duke shënuar rritje në krahasim me vitin 2015. Ndërkohë, KShH ka monitoruar gjatë periudhës korrik-tetor 2016 rreth 97 seanca gjyqësore penale dhe civile, me objekt “*Dhuna në Familje*”, “*Lëshim urdhër mbrojtje* dhe “*Lëshim urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes*”, gjetjet e të cilave janë trajtuar më gjerë në rubrikën për çështjet e diskriminimit gjinor.

Moszbatimi i rregullave të qarkullimit rrugor, mungesa e ndërgjegjësimit të shtetasve për rëndësinë e respektimit të tyre, konfliktet e trashëguara apo të çastit mbi pronësinë, si dhe përplasja midis grupeve rivale të organizatave kriminale, veçanërisht në trafikimin e lëndëve narkotike vazhdojnë të mbeten faktorë deçiziv në cenimin e së drejtës së jetës së shtetasve,

<sup>3</sup> Verifikim i realizuar me dt. 17.01.2017 në Shërbimin e Sanatoriumit, Spitali Rajonal Korçë.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të Policisë së Shtetit në luftën kundër formave të tilla të kriminalitetit.

Është pozitiv fakti se gjatë vitit 2016 ka patur mungesë të rasteve të gjakmarrjes në vend si dhe janë pakësuar aksidentet në punë për shkak të shkeljes, ose mungesës së kushteve teknike dhe të sigurisë, kryesisht në hidrocentrale, miniera, kantiere ndërtimi, etj. Pranë KShH-së janë paraqitur ankesa nga përfaqësues të sindikatave të naftëtarëve, për mosrespektim të detyrimeve financiare nga kontraktorët e organeve të administratës publike.

Referuar Raportit të Komisionit Evropian<sup>4</sup>, kuadri ligjor për luftën ndaj **trafikimit njerëzor** është zhvilluar më tej dhe sanksionet janë rënduar, por mbetet ende për t'u bërë në drejtim të përafrimit me *acquis* të BE-së. KE çmon se Shqipëria duhet të shtojë përpjekjet për parandalimin e trafikimit njerëzor, *duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve të pashoqëruar dhe fëmijëve që janë viktimë të trafikimit, veçanërisht fëmijëve në situatë rruge*. Numri i dënimeve për këto vepra penale mbetet i ulët, ku nga 38 raste të raportuara nga policia në gjysmën e parë të vitit 2016, vetëm në dy raste janë marrë vendime dënimi me burgim të formës së prerë. Gjatë vitit nuk kanë munguar raste të aksioneve policore që kanë rezultuar me arrestimin në flagrancë të shtetasve, kryesisht menaxherë lokalesh nate, për shkak të dyshimeve për mbajtje ambjentesh për ushtrim apo shfrytëzim prostitucioni.

## 3.2 E drejta për të zgjedhur e për t'u zgjedhur

Në muajin shtator 2016, KShH ka monitoruar në mënyrë të kufizuar vetëm zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Dibër, ku ndër të tjera është konstatuar një klimë politike relativisht e tensionuar për shkak të akuzave reciproke të përfaqësuesve të koalicioneve, si dhe ka patur pretendime për presion, angazhim të administratës publike të institucioneve të kësaj bashkie në fushatën zgjedhore, pretendime për blerje të votës, etj.

Nga verifikimi në terren, vëzhguesit e KShH-së konstatuan se listat e zgjedhësve të afishuara në Qendrat e Votimit (QV) të monitoruara nuk përmbanin datën e shpalljes së tyre. Monitorimi i pjesshëm i KShH-së evidentoi se, në 2-3 raste ka pasur pretendime për mungesën e emrit në listat e zgjedhësve për të cilat është proceduar duke dhënë vërtetimin përkatës të KZAZ-së dhe janë orientuar shtetasit për t'ju drejtuar gjykatës.

Në disa raste, listat e zgjedhësve u vendosën në vende të papërshtatshme dhe të pakësueshme lehtësisht nga zgjedhësit ose ishin vendosur pranë mjediseve publike, kryesisht arsimore, të cilat në orët e pasdites ishin të mbyllura dhe nuk mundësonin shikimin e lirshëm të listave nga shtetasit. Ndërkohë u vërejtën disa përmirësime në drejtim të cilësisë së listave të zgjedhësve, reduktimit të ndikimit partiak të organeve të administrimit zgjedhor, sjelljes së votuesve, apo pasqyrimin të gjerë në media të procesit<sup>5</sup>.

Gjatë vitit 2016, KShH ka ndjekur ecurinë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore si dhe i ka adresuar këtij Komisioni 32 propozime për ndryshime dhe përmirësime në Kodin Zgjedhor, në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Veprimtaria e këtij Komisioni për shqyrtimin dhe reflektimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it si dhe për hartimin dhe miratimin në kohë të ndryshimeve të nevojshme në Kodin Zgjedhor ka shfaqur

<sup>4</sup> Komunikim i vitit 2016 për Politikën BE-së për Zgjerim

<sup>5</sup> [http://ahc.org.al/web/images/Raporte/AL/Final\\_Raport\\_Zgjedhjet\\_Kryetar\\_Diber\\_1.pdf](http://ahc.org.al/web/images/Raporte/AL/Final_Raport_Zgjedhjet_Kryetar_Diber_1.pdf)



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

vonesa. Është ngritur si shqetësim se këto vonesa mund të prekin parimin e gjithëpërfshirjes, i cili kërkon angazhim dhe kontribut edhe të aktorëve të shoqërisë civile dhe ekspertëve të fushës. Gjithashtu, këto vonesa mendojmë se do të ndikojnë në reflektimin jo të plotë të të gjitha rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, çka mund të çojë në realizimin e një reforme të pjesshme zgjedhore.

### 3.3 E drejta e pronës

E drejta e pronës është e parashikuar në nenin 41 të Kushtetutës, si pjesë e lirive dhe të drejtave vetjake. Kushtetuta parashikon kufizimin e të drejtës së pronës vetëm për interesa publikë, ndërkohë që shteti duhet të garantojë në çdo rast thelbin e kësaj të drejte për shkak të rëndësisë që ka ajo në një shoqëri demokratike, me një ekonomi tregu funksionale.

Ankesat e ardhura në adresë të KShH-së gjatë vitit 2016, evidentojnë se 9% e qytetarëve ankohen për cenim të së drejtës së pronësisë. Pretendime për masën e ulët të kompensimit për shpronësimin, si pasojë e punimeve në kuadër të gazsjellësit TAP në bashkitë e Korçës, Beratit apo Fierit, si dhe pretendimet për dëmtime të shkaktuara nga ndërtimi i rrugëve që shoqërojnë gjurmën e projektit, janë ankesa konkrete të adresuara gjatë veprimtarisë monitoruese të KShH-së. Verifikimi në terren, këshillimi ligjor dhe ndërhyrjet institucionale janë format kryesore të trajtimit ligjor të problemeve të konstatuara. Nuk kanë munguar raste ankesash nga banorë të bashkive të tjera të vendit, me pretendimin e mungesës së shlyerjes në kohë dhe në masën e duhur të vlerës së shpronësimit për interes publik.

Kanë vijuar problematikat për strehimin e Komunitetit rom, ku disa familje të këtij komuniteti janë zhvendosur në mënyrë të detyruar nga zona e Bregut të Lumit, në Tiranë, si pasojë e nevojës së zbatimit të planit për kalimin e segmentit të Unazës së Bashkisë Tiranë, në hapësirën ku ndodheshin banesat e një pjese të këtij Komuniteti. Praktika institucionale e zhvendosjes së tyre nga autoritetet shtetërore qendrore dhe lokale, pa marrë më parë masat për strehimin e këtyre shtetasve, ka sjellë reagimi të banorëve dhe shoqërisë civile, përfshirë KShH-në.

Në dhjetor të vitit 2015, Kuvendi miratoi ligjin e ri nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Ky ligj hyri në fuqi në muajin shkurt të vitit të kaluar dhe është ankimuar në Gjykatën Kushtetuese nga grupet e interesit, ku është pretenduar cenim i parimit të sigurisë juridike dhe parimit të barazisë së trajtimit të pronarëve. Me vendimin nr.1, dt. 16.01.2017, Gjykata Kushtetuese vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës duke vendosur shfuqizimin si antikushtetues të nenit 6, pika 3 dhe 5, të ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe refuzimin e kërkesës për pjesën tjetër të objektit të saj. Sipas Komisionit Evropian<sup>6</sup>, Strategjia 2012-2020 për të drejtat e pronësisë duhet të përmirësohet në drejtim të koordinimit ndërmjet proceseve të kthimit, kompensimit dhe legalizimit. Mbivendosja e pronave duhet të adresohet për zgjidhje të shpejtë, nëpërmjet dixhitalizimit në regjistrimin dhe planifikimin e pronës.

### 3.4 Liria e Medias

Media është një faktor i rëndësishëm në luftën për drejtësi dhe kundër varfërisë si dhe për t'u dhënë zë grupeve më të cënuara të shoqërisë. Garantimi i medias së lirë ndihmon gjithashtu

<sup>6</sup> Komunikim i vitit 2016 për Politikën BE-së për Zgjerim, fq.79



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

debatin publik si dhe rrit përgjegjësinë e përfaqësuesve të zgjedhur dhe zyrtarëve të tjerë që duhet të vihen në shërbim të njerëzve.

Edhe në vitin 2016 kemi vlerësuar dhe shfrytëzuar informacionin e dhënë në media, gjë që na ka shërbyer për verifikime të mëtejshme dhe sipas rasti edhe për prononcime publike.

Ka disa të dhëna, edhe pse të paverifikuara, që flasin, se ka ende gazetarë që punojnë në informalitet, të cilëve nuk u paguhet rregullisht paga apo të cilët nuk përfitojnë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Me rastin e ditës së lirisë së shtypit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Shoqata “Pro LGBT” dhe Civil Rights Defenders kanë bërë gjithashtu thirrje për respektimin e lirisë së shtypit dhe ndalimin e censurës e vetëcensurës.

Ankesa e gazetares së pushuar nga puna në një televizion privat, për investigimin e kryer për rrethanat e vdekjes së të miturit në Landfillin e Sharrës, si dhe censurimi i transmetimit të kësaj videoje çoi në reagimin tonë se gazetaria investigative ka nevojë për më shumë mbrojtje dhe inkurajim dhe se gazetaria serioze nuk mund të ekzistojë pa burimet e informacionit. Gjithashtu, KShH ka reaguar në maj të 2016-ës duke ngritur me shqetësim rastin e ushtrimit të dhunës ndaj një gazetari sportiv.

Sipas indeksit për lirinë e medias në botë për vitin 2016, Reporterët pa Kufij referojnë se Shqipëria nuk ka shënuar progres dhe renditet në të njëjtin vend si në vitin që lamë pas, përkatësisht në vendin e 82-të mes 180 shteteve të analizuara në botë. Këto të dhëna kërkojnë reflektim dhe vëmendje nga autoritetet rregullatore në fushën e medias, gazetarët, përfaqësuesit e organizatave jofitimprurëse që mbrojnë të Drejtat dhe liritë e shtetasve dhe shoqëria civile në tërësi.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2016<sup>7</sup>, vendi konsiderohet mesatarisht i përgatitur për respektimin e lirisë së shprehjes, ndërkohë që nuk ka pasur progres krahasuar me vitin e kaluar në këtë drejtim. Procedura e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Radio Televizionit Shqiptar, përmes shumicës së thjeshtë parlamentare pas tri raundeve, siç parashikohet në ligjin e ndryshuar, vlerësohet nga KE-ja kufizues në mundësinë e emërimit të një personaliteti të barazlanguar politikisht.

Në raste specifike, KShH ka ngritur shqetësimin në rrugë institucionale te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për mungesën e standardeve etike dhe profesionale në gazetari që kanë çuar në cenimin e të dhënave personale dhe të së drejtës për një jetë private.

### 3.5 Drejtësia

#### 3.5.1 Reforma në Sistemin e Drejtësisë

Gjatë vitit 2016 është konstatuar progres, veçanërisht me miratimin e ndryshimeve kushtetuese për reformimin e sistemit të drejtësisë, me votat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. KShH vlerëson kontributin dhe ekspertizën vendase dhe në mënyrë të veçantë angazhimin e asistencës ndërkombëtare.

<sup>7</sup> Komunikim i vitit 2016 për Politikën BE-së për Zgjerim, fq.26



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Gjithashtu, është miratuar një paketë ligjore, prej 7 ligjesh organike, e cila parashikon rregulla të detajuara për rivlerësimin e gjykatësve, prokurorëve dhe këshilltarëve juridikë (i njohur ndryshe si procesi i ‘vettingut’), organizimin e përgjithshëm të gjyqësorit, prokurorisë, statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, krijimin e institucioneve të specializuara për luftën kundër krimit të organizuar dhe antikorrupsionit, krijimin e institucioneve të reja për qeverisjen e sistemit të drejtësisë si dhe janë në proces përgatitjeje 27 projektligje të tjera që lidhen me Reformën në Drejtësi.

Në fund të vitit 2016, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë vendosi rrëzimin e kërkesës me objekt konstatimin e antikushtetutshmërisë së ligjit të vettingut, duke u bazuar veçanërisht në *amicus curiae* (opinionin këshillimor) të Komisionit të Venecias, kërkuar kryesisht nga kjo gjykatë.

Sipas Komisionit Evropian, rekomandimet e adresuara vitin e shkuar nuk kanë shënuar progres në zbatim, lidhur me plotësimin e vendeve të lira në Gjykatën e Lartë dhe gjykatat administrative; përdorimin efektiv të sistemit të unifikuar për menaxhimin e çështjeve, si dhe publikimin në kohë të të gjitha vendimeve gjyqësore së bashku me praktikën e tyre.

KShH vlerëson se është prioritarë miratimi dhe zbatimi i plotë i të gjithë paketës ligjore për reformimin e sistemit të drejtësisë, me konsensus të gjerë parlamentar<sup>8</sup> dhe me pjesëmarrjen e konsultimin e grupeve të interesit. Vetëm në këtë mënyrë do të krijohet një sistem gjyqësor efikas që respekton maksimalisht liritë dhe të drejtat e njeriut, e në mënyrë të veçantë të drejtën për një proces të rregullt.

### 3.5.2 Ankesat ndaj Gjyqësorit dhe Prokurorisë

Gjatë këtij viti, pranë KShH-së janë paraqitur një numër më i madh ankesash<sup>9</sup> në lidhje me veprimtarinë e organeve të drejtësisë, krahasuar me vitin 2015. Përkatësisht, 21% e totalit të ankesave, që i janë adresuar KShH-së, përbëhet nga pretendimet për shkelje të të drejtave të individit nga veprimtaria e organeve të drejtësisë, por sidomos nga gjykatat. Kryesisht qytetarët ankohen për vendime të padrejta gjyqësore, korrupsion në radhët e sistemit, cenim të procesit të rregullt ligjor, zvarritje të procesit gjyqësor apo ankesë për mospërfitim nga ulja e dënimit apo lirimi me kusht, mosekzekutim i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet shtetërore, përfshirë prokurorinë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB).

Sikurse është konstatuar vitet e shkuara, nga monitorimet e kryera nga KShH në disa gjykata për çështje të lidhura me korrupsionin, dhunën në familje apo për verifikimin e ankesave sporadike, ka rezultuar se, shpesh, proceset gjyqësore janë zvarritur për shkak të mungesës në seancat gjyqësore të prokurorit, mbrojtësit dhe, në disa raste, të vetë gjyqtarit të çështjes. Shpesh seancat janë zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve, të cilat nuk kanë hapësirë dhe kushte të përshtatshme për qëndrimin e palëve dhe prezencën e publikut, duke shkelur kështu solemnitetin dhe publicitetin e gjykimit. Ka patur edhe ndonjë rast që vëzhguesit e KShH-së janë penguar të jenë të pranishëm në seancat gjyqësore që duhet të ishin të hapura për publikun. Sjellje të papërshtatshme, apo shkelje të etikës gjatë procesit gjyqësor janë konstatuar nga vëzhgues të KShH-së për shkak të ndërhyrjes së palëve ose të përfaqësuesve të tyre, mungesës

---

<sup>8</sup> Deklaratë për shtyp e KShH, dt.22.07.2016: “Përshëndesim miratimin me konsensus të Reformës në Drejtësi”

<sup>9</sup> Të dytat për nga sasia me një numër prej 40 ankesash.





# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

së vëmendjes nga gjyqtarët ose palët, shkeljes së paanshmërisë të gjyqtarit ndaj palëve, etj. Ndërkohë vlen të evidentohet Progres Raporti i vitit 2016 të Komisionit për Shqipërinë ku nënvizohet se *“Kodi i etikës për gjykatësit, i vitit 2000, nuk ka patur asnjë ndikim konkret mbi llogaridhënien e tyre, pavarësisht se etika profesionale është një nga temat e mbuluara në programin e trajnimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës... nuk ka monitorim të mjaftueshëm për respektimin e standardeve etike dhe integritetit të gjykatësve dhe prokurorëve...”*.

Në studimet e realizuara në kuadër të zbatimit të projekteve në fushën e Drejtësisë, KShH ka konstatuar aplikimin e institutit të *“Gjykimit të shkurtuar”* edhe në rastet kur vepra penale ka sjellë pasoja shumë të rënda, për shtetin apo shtetasit. KShH mbetet e qëndrimit për nevojën e ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale dhe një praktike të unifikuar për gjykatat, me qëllim pengimin e favorizimit duke ulur me 1/3-ën masën e dënimit të dhënë për personat që janë recidivistë apo me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Shkeljet procedurale gjatë hetimit si dhe veprimet e padrejta apo arbitrare nga organi i ndjekjes penale përbëjnë objektin e rreth 6 % të ankesave të adresuar në drejtim të KShH-së gjatë 2016, nga shtetas të paraburgosur, nën hetim apo të padënuar. Në komunikimin institucional, KShH ka konstatuar një farë përmirësimi të prokurorisë në drejtim të transparencës dhe informimit, por në çështje konkrete, disa prokurori në rrethe kanë shfaqur hezitim në ofrimin e informacionit të kërkuar. Zvarritja e hetimeve, mosrespektimi i të drejtave procedurale të personave nën hetim apo të pandehur për kthimin e përgjigjeve ndaj memove apo kërkesave me shkrim, si dhe mungesa e njoftimit për vendimin e zgjatjes së afatit të hetimit janë shqetësimet e adresuara nga disa shtetas.

Mirëfunksionimi i organit të prokurorisë, pavarësia dhe integriteti moral dhe profesional i prokurorëve janë thelbësore për efektivitetin e ndjekjes penale dhe rritjes së ndëshkueshmërisë së krimit në nivele të larta të administratës publike dhe politike. Referuar Raportit të KE-së<sup>10</sup>, Prokuroria e Përgjithshme (PP) ka marrë masa disiplinore *“qortim”* vetëm ndaj dy prokurorëve, me propozim të Këshillit të Prokurorëve. Një prokuror u dënua nga Gjykata e Krimeve të Rënda me burgim për veprën e korrupsionit dhe një prokuror tjetër është pezulluar nga detyra për shkak të një videoje ku implikohej si i dyshuar në një akt korruptiv për një çështje nën hetim prej tij.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ILDKPKI dhe Avokati i Popullit nëpërmjet raporteve vjetore apo deklaratave publike kanë shprehur kritika për refuzimin e fillimit të ndjekjes penale apo pushimin e çështjeve veçanërisht ndaj zyrtarëve të lartë, të kallëzuar prej tyre.

### 3.5.3 Shërbimi ligjor falas

E drejta për mbrojtje efektive në një proces gjyqësor është element thelbësor i të drejtës për proces të rregullt ligjor, parashikuar në Kushtetutë dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Për më shumë se një dekadë, KShH vazhdon të ofrojë shërbime ligjore për grupet në nevojë. Gjatë vitit 2016 përfitues të ndihmës ligjore kanë qenë personat me liri të kufizuar, antarë të Komunitetit rom dhe egjiptian, gratë, persona me aftësi të kufizuar, personat që nuk kanë mundësi financiare për të paguar një avokat, etj. KShH dhe disa OJF të tjera kanë vazhduar të kontribuojnë në këtë drejtim, në kuadër të mbështetjes së dhënë nga donatorë të ndryshëm.

<sup>10</sup> Komunikim për Shqipërinë 2016 i KE-së, fq.72.





# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Në procese gjyqësore të monitoruara nga KShH rezulton se avokatët e caktuar kryesisht nga gjykata dhe prokuroria, shpesh e kryejnë detyrën e mbrojtësit formalisht dhe është vërejtur mungesë profesionalizmi. Në mënyrë të veçantë, të paraburgosurit dhe të dënuarit ankohen për cilësinë e dobët të mbrojtjes së këtyre avokatëve. KShH vlerëson se nevojitet të rregullohet mënyra se si caktohen mbrojtësit kryesisht nga prokurori i çështjes për të pandehurin apo personin në hetim, gjatë hetimeve paraprake. Rregullimi aktual çon në zgjedhje të njëanshme të këtyre mbrojtësve dhe rrjedhimisht mosrespektim të kërkesave për proces të rregullt.

Komisioni i Ndhmës Juridike është institucion i ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe sipas ligjit duhet të ofrojë shërbime ligjore falas për shtetasit në pamundësi financiare. Ky Komision nuk mund të përmbushë të gjitha nevojat e shtetasve për shërbime ligjore falas, çka ka sjellë dhe mungesë besimi te qytetarët për efikasitetin e tij. Përfaqësues të Komisionit adresojnë shqetësimin se kjo vjen si rezultat i mungesës së buxhetit të mjaftueshëm që caktohet nga shteti për veprimtarinë e tij.

KShH ka vazhduar monitorimin e situatës së respektimit të të drejtave të njeriut në vend, duke synuar parandalimin e shkeljeve potenciale dhe rivendosjen e të drejtave të shkelura. Në këtë drejtim, një nga mjetet e përdorura ka qenë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve ligjore në kuadër të Klinikës Ligjore falas. Kemi treguar vëmendje të veçantë për dëgjimin, verifikimin dhe zgjidhjen e ankesave të qytetarëve. Gjatë vitit 2016, nga stafi i KShH-së janë trajtuar 290 ankesa, të cilat janë adresuar nëpërmjet telefonatave, e-mail, letrave ose takimeve të drejtëpërdrejta. Objekti i ankesave ka vazhduar të dominohet (rreth 40 % e totalit) nga kushtet e papërshtatshme dhe shkelja e të drejtave të të burgosurve, mosdhënia e shërbimit shëndetësor në sistemin e burgjeve, etj. 21 % e ankesave i adresohet gjykatave dhe prokurorive, sikurse është përmendur edhe më herët në këtë raport. Ankesat për shërbim avokator dhe konfliktet e pronësisë, veçanërisht pretendime për kompensime jo proporcionale gjatë shpronësimeve kanë pësuar një rritje, duke përbërë rreth 19 % të totalit.

Ankuesit i përkasin grupmoshave të ndryshme por të gjithë të rritur, qyteteve të shpërndara gjeografikisht, veçanërisht të lidhura me vendodhjen e institucioneve penitenciare, pa përjashtuar raste të shtetasve nga Kosova, emigrantët apo shtetasit e huaj me liri të kufizuar. Individët që i janë adresuar KShH-së për trajtimin e shqetësimeve të tyre **i përkasin të dyja gjinive**, ku më së shumti dominojnë **meshkujt e rritur në rreth 84%**. Rreth 11% e ankesave vijnë nga shtetasit që i përkasin minoriteteve, kryesisht persona të minoritetit rom.

Në fokus të veçantë të ofrimit të shërbimeve ligjore falas kanë qenë rastet e litigimit strategjik, ku me anë të ndërhyrjeve për një rast specifik, synohet zgjidhje për një grup më të gjerë personash që ndodhen në të njëjtën situatë ose në situatë të ngjashme me personin që përfaqësohet. Gjatë 2016-ës, KShH ka paraqitur katër kërkesa në Gjykatën e Strasburgut, objektivi i të cilave është ndër të tjerash, marrja e masave të përgjithshme nga kjo Gjykatë, ku t'i kërkohet shtetit shqiptar ndryshimi i legjislacionit ose praktikave institucionale që nuk janë në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata e Strasburgut ka pranuar kërkesën e KShH-së për Marrjen e Masës së Përkohshme sipas Rregullit 39 të kësaj Gjykate dhe urdhëroi autoritetet shtetërore Shqiptare që, në mënyrë urgjente, t'i sigurohet trajtimi i kërkuar mjekësor të dënuarit F.Z. Ndërkohë që Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë pranoi kërkesën e KShH-së për të njëjtën çështje, mbi konstatimin e shkeljes së procesit të rregullt ligjor, si pasojë e moszbatimit nga Drejtoria e Përgjithshme e



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Burgjeve dhe Ministria e Shëndetësisë, e vendimit gjyqësor të formës së prerë, për dhënien e shërbimit shëndetësor ndaj të dënuarit, në një afat të arsyeshëm.

### 3.5.4 Lufta kundër korrupsionit dhe pandëshkueshmëria e tij

Korrupsioni në vendin tonë dhe pandëshkueshmëria e tij mbeten problem shqetësues për qytetarët, të cilët kanë humbur besimin tek organet e drejtësisë. Kjo është evidentuar nga disa organizata vendase dhe ndërkombëtare kryesisht nëpërmjet raporteve të publikuara gjatë vitit 2016. Shpesh trupi diplomatik i akredituar në vendin tonë ka adresuar deklarata të forta në lidhje me këtë fenomen, duke vënë theksin te korrupsioni i përhapur në sistemin e drejtësisë të lidhur me korrupsionin në nivel politik.

Lufta kundër korrupsionit është një nga 5 prioritetet kryesore që vendi ynë duhet të përmbush në kuadër të integritimit evropian. Në Raportin për Shqipërinë gjatë 2016, KE vlerëson se *ka patur një prirje pozitive që prej vitit 2010 në numrin e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve të formës së prerë në rastet e korrupsionit për zyrtarët e nivelit të ulët apo të mesëm, megjithatë historiku i të dhënave mbetet i ulët në përgjithësi, veçanërisht për rastet e korrupsionit të zyrtarëve të nivelit të lartë.*

Në Raportin e Transparency International gjatë 2016-ës, Shqipëria zë vendin e 83-të nga 176 shtete të përfshira në indeks, e vlerësuar me 39 pikë, duke shënuar një përmirësim prej 17 vendesh<sup>11</sup>. Ndërsa në Raportin e “Freedom House”<sup>12</sup> për Shqipërinë, dënimet për zyrtarët e nivelit të lartë apo gjyqtarët në lidhje me korrupsionin apo shpërdorimin e detyrës janë të rralla.

Monitorimi i seancave gjyqësore për korrupsionin ka qenë në fokus të veprimtarisë së KShH-së gjatë vitit 2016. Nga monitorimi i më shumë se 50 seancave gjyqësore në gjykatat e Tiranës dhe Durrësit, të lidhura me veprën penale të korrupsionit rezulton se:

- a) rreth 77 % e tyre u çelën me vonesë;
- b) 13 % e seancave u zhvilluan në zyrat e gjyqtarëve të shkallës së parë;
- c) kohëzgjatja mesatare e gjykimit ka qenë 138 ditë për shkak të zvarritjeve që burojnë nga mungesa e përfaqësuesit të prokurorisë, e të pandehurit apo mbrojtësit të tij, mungesa e antarëve të trupit gjykues për formimin e kuorumit të nevojshëm, mosnjohimi efektiv i dëshmitarëve të thirrur në gjykim, mungesa e ekspertëve apo përkthyesve, nevoja për riformulim e kërkesës për gjykim, etj.
- d) masa e sigurimit “arrest me burg” është aplikuar në 50% të rasteve, ku 80% e të pandehurve të hetuar/gjykuar me këtë masë i përkasin pothuajse në të gjitha rastet nivelit të ulët drejtues dhe ekzekutiv<sup>13</sup>.
- e) dënimet e dhëna për rastet e korrupsionit apo shpërdorimit të detyrës kanë tendencën të jenë të lehta dhe joproportionale në raport me rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale.

Nevojitet hetim proaktiv dhe ndjekje penale efektive me qëllim rritjen e rasteve të hetimit financiar dhe konfiskimit të pasurisë, veçanërisht ndaj krimit të organizuar në sektorin publik, i ndihmuar nga korrupsioni<sup>14</sup>.

<sup>11</sup> [http://www.transparency.org/news/feature/corruption\\_perceptions\\_index\\_2016](http://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016)

<sup>12</sup> <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2016/albania>

<sup>13</sup> <http://ahc.org.al/new/wp-content/uploads/2016/12/raport-studimor24.12.16.pdf>



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

KShH vlerëson iniciativat e shoqërisë civile dhe medias investigative, të cilat në dobi të interesit publik kanë evidentuar dhe ndjekur rastet e korrupsionit. Referuar të dhënave të një studimi të realizuar në fillim të vitit 2016 nga BIRN, 81 gjyqtarët e Apelit në vend kanë një pasuri në total 2 miliardë lekë pasuri të investuara në pasuri të paluajtshme, kompani biznesi apo në vlera të mëdha monetare në bankë apo cash, 80% prej të cilëve nuk arrijnë të justifikojnë atë nga të ardhurat e tyre<sup>15</sup>.

### *3.6 Të drejtat e personave me liri të kufizuar*

Edhe gjatë këtij viti, KShH monitoroi veprimtarinë në institucionet e Policisë së Shtetit, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, si dhe trajtoi me përparësi ankesat e personave me liri të kufizuar, të cilat përgjithësisht kishin të bënin me shërbimin shëndetësor, transferimet, ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor, kushtet e jetesës, mënyrën e dhënies së lejeve, ruajtjen e integritetit fizik dhe sigurinë e të burgosurve, respektimin e të drejtave që lidhen me marrëdhëniet familjare, korrespondencën, etj.

Më shumë se 64% e ankesave drejtuar KShH-së vijnë nga shtetasit e paraburgosur dhe të dënuar, të cilët ankohen për kushtet e papërshtatshme dhe shkelje të të drejtave të këtyre shtetasve nga administrata e burgjeve. 33% e ankuesve pretendojnë mosdhënie të shërbimit shëndetësor të përshtatshëm dhe kushte të papërshtatshme jetese në institucion. Pavarësisht numrit të pakët, nuk kanë munguar shqetësime të ngritura lidhur me transferimin në një institucion apo dhomë tjetër, cenim i korrespondencës, ose mënyrën arbitrare të shpërblimit në vlerë monetare të punës së të burgosurve, etj. Gjithashtu, 28% dhe 25% e ankesave të personave të privuar nga liria i referohen përkatësisht shkeljeve që lidhen me nenet 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor) dhe 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së.

KShH vlerëson pozitivisht uljen e numrit të pretendimeve të të paraburgosurve apo të dënuarve për ushtrim dhune në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

KShH-ja ka përcjellë, pranë institucioneve përkatëse, një numër të madh rekomandimesh dhe ka sugjeruar marrjen e masave për zbatimin e legjisllacionit në fuqi, të cilat, përgjithësisht janë konsideruar në mënyrë konstruktive. Institucione si Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, IEVP-të dhe institucione të tjera, na janë përgjigjur për çështjet e ngritura mbi funksionimin e veprimtarisë në kuadër të respektimit të të drejtave të personave me liri të kufizuar, duke informuar rreth masave të marra, ose për trajtimin e tyre në vijim. Në mënyrë të veçantë, veçojmë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, transparencën e treguar dhe reflektimet e këtij institucioni ndaj problematikave të adresuara për trajtim nga KShH. Nuk kanë munguar rastet ku, disa institucione shtetërore nuk kanë dërguar përgjigje lidhur me rekomandimet e KShH-së, ose informimi nuk ka qenë i plotë.

KShH i mbetet qëndrimit se Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve (ShKB) si struktura që parandalon, zbulon apo dokumenton veprimtarinë kriminale të kryer nga punonjësit me ose

---

<sup>14</sup> Qëndrim i mbajtur nga KE ne Raportimin për Shqipërinë në 2016.

<sup>15</sup> <http://www.reporter.al/investigime/>



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

pa uniformë në sistemin e Burgjeve, nevojitet të intensifikojë kontrollet dhe mbikëqyrjen, për të luftuar fuqimisht ndaj abuzimeve në sistemin e burgjeve. KShH rekomandon se ky organ duhet të tregojë më tepër objektivitet dhe paanshmëri.

Korrupsioni në sistemin penitenciar mbetet shqetësim serioz i të burgosurve, fenomen i adresuar edhe ne Raportimin për Shqipërinë gjatë 2016-ës nga Komisioni Evropian. Në disa raste të dënuarit dhe të paraburgosurit pretenduan për çmime abuzive të artikujve që shiteshin në dyqanet e institucioneve si dhe blerjes së këtyre artikujve pa kuponin tatimor ose faturën e njehsuar me të. Korrupsioni pretendohet gjithashtu në krijimin e kushteve favorizuese brenda mjediseve të institucionit për të marrë një shërbim më të mirë si dhe në marrjen e lejeve shpërblyese dhe lejeve të veçanta, paraqitjen e raporteve nga institucioni që ndikojnë në vendimet gjyqësore për uljen e dënimit ose aplikimin e lirisë me kusht.

### **3.6.1 Respektimi i të drejtave të personave të privuar nga liria në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale**

#### *a) Mbipopullimi*

Edhe gjatë vitit 2016, mbipopullimi në institucionet penitenciare ka vazhduar të jetë shqetësues, sidomos në gjashtë mujorin e dytë të tij. Mbipopullimi në paraburgim ka qenë veçanërisht shqetësues, ndërkohë që masa e sigurisë arrest në burg zbatohet ndaj të pandehurve në numër të konsiderueshëm. Standartet ndërkombëtare parashikojnë që kjo masë duhet të zbatohet si masë e fundit ose e jashtëzakonshme. Dënimet alternative zbatohen në raste relativisht të pakta nga gjykatat.

Ndërkohë që ligji “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor” është miratuar në vitin 2011 dhe mbikëqyrja ka filluar funksionimin në vitin 2013, sërish konstatohen probleme në drejtim të zbatimit efektiv të tij. Niveli i zbatimit të këtij ligji nuk ka mundur të ndikojë në uljen e mbipopullimit në sistemin e burgjeve. Moszbatimi i mbikëqyrjes elektronike për autorët e dhunës në familje ka rezultuar me pasoja fatale në disa raste të publikuara nga media, duke mos arritur të parandalohen vepra me rrezikshmëri të lartë shoqërore, për të cilën KShH ka reaguar publikisht.

Me miratimin e ligjit të amnistisë në fund të vitit përfituan mbi 700 të burgosur. KShH ka adresuar rekomandime në drejtim të Shërbimit të Proves dhe prokurorisë, për të realizuar komunikim e bashkëpunim efektiv për lirimin e të dënuarve apo paraburgosurve që përfituan nga amnistia. Në disa raste u vërejtën vonesa në drejtim të zbatimit të këtij ligji dhe të dyja këto institucione e kalonin përgjegjësinë tek njëra-tjetra. Mbetet sfidë shtimi i dënimeve alternative nga organet e drejtësisë, për veprat penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe të pandikuara nga politika penale afatshkurtër .

#### *b) Kushtet dhe infrastruktura*

Kanë vijuar problematikat në drejtim të infrastrukturës së papërshtatshme dhe kushteve jo të mira materiale, të cilat, në disa nga institucionet penitenciare të monitoruara mund të çojnë deri në trajtim çnjerëzor dhe degradues.

Konkretisht është konstatuar kubaturë e vogël e qelive, mungesë e ndriçimit natyral, artificial, lagështirë, amortizim, mungesë e ngrohjes, ventilimit, fjetja në tokë e të dënuarve ose të



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

paraburgosurve për shkak të mbipopullimit, mungesë e dyshekëve, rrobave të fjetjes, tualete pa dyer në qeli të caktuara, tualete të ndotura dhe me pajisje të amortizuara, qeli me dritare të thyera apo pa xhama, etj. Këto problematika janë vërejtur në Institucionet Penitenciare Sarandë, Lushnjë, Rrogozhinë, Fushë – Krujë, Tepelenë, Zahari (Krujë), Burrel. Në disa prej këtyre institucione problematikat janë të lidhura me infrastrukturën e vjetër të godinave ku janë vendosur, të cilat rezultojnë të jenë ndërtuar para vitit 1945. Për institucionin e Zaharisë në Krujë, KShH ka rekomanduar mbylljen e tij pasi kushtet e tij bien në nivelin e një trajtimi çnjerëzor dhe degradues për të dënuarit të diagnostikuar me sëmundje të ndryshme dhe shtetasit me masë mjekësore.

Në disa raste është cenuar siguria në sistemin e burgjeve dhe për rrjedhojë të dënuar ose të paraburgosur kanë humbur jetën ose kanë pësuar dëmtime të shëndetit. Vetëvrasjet dhe çdo incident tjetër kërkojnë një hetim të gjithanshëm, të plotë dhe objektiv të prokurorisë, pasi sistemi i burgjeve duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të tyre. Garancitë dhe mekanizmat për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të shtetasve që ju është kufizuar liria duhet të jenë efektive.

Nga monitorimi i vendeve të privimit të lirisë ku qëndrojnë të miturit, është vërejtur se kërkohet kujdes më i veçantë për përmirësimin e mbajtjes së higjienës në disa dhoma/mjedise të qëndrimit të të miturve. Përcaktimi i objektivave konkretë në planin individual të dënimit të gjithësecilit të mitur dhe më tej puna e ekipeve multidisiplinare me ta, do të ishte një faktor me efekt pozitiv për arritjen e këtyre objektivave.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB), me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë, nevojitet të marrë masat masa për respektimin e parametrave ligjorë të dhomave, sigurimin e krevatit e kompletit të përshtatshëm për fjetje, mjediseve të hapura dhe të gjera të ajrimit, për sigurimin e ngrohjes së mjedisit, si dhe pajisjen me mjetet e higjienës për çdo të burgosur, siç parashikohet në ligj, në respekt të dinjitetit njerëzor.

## *c) Rehabilitimi dhe kujdesi psiko-social*

Rehabilitimi synon riintegrimin e të dënuarve në shoqëri dhe përbën një nga objektivat kryesor të politikës penale bashkëkohore, e cila ka si qëllim të luftojë recidivizmin apo përsëritjen e veprës penale nga i dënuari.

Në rehabilitimin e të dënuarve një rol mjaft të rëndësishëm luan personeli i burgjeve, sidomos ata që ngarkohen me zbatimin e programeve për edukimin, arsimimin dhe aktivitetet e tjera që parashikohen në ligj. Rekrutimi në sistemin e burgjeve nuk mundëson punësimin e personave me integritet, të kualifikuar dhe të motivuar financiarisht. Është fakt i njohur që në burgjet tona, herë pas here, punonjës të veçantë janë shkarkuar nga detyra apo proceduar për korrupsion apo shpërdorim detyre. Raste të tilla u shënuan edhe gjatë vitit 2016, në radhët e zyrtarëve të nivelit të lartë në këtë sistem.

Edhe pse jo një konstatim përgjithësues, një pjesë e personelit të administratës në burgje vlerësojnë se nuk kanë ende njohuritë e duhura për legjislacionin penal, legjislacionin penitenciar, rregullat minimale të burgjeve të Kombeve të Bashkuara, njohuri të posaçme në fushën e krimnologjisë, metodikave bashkëkohore për krijimin e raporteve të drejta me të dënuarit, parandalimin e vetëvrasjeve apo konflikteve të brendshme midis të burgosurve të veçantë. Gjatë 2016-ës, KShH ka vazhduar të trajtojë personelin e burgjeve me qëllim rritjen e





## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

kapaciteteve nëpërmjet ekspertizës ndërkombëtare dhe vendase, veçanërisht me fokus trajtimin human të personave që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standartet ndërkombëtare.

Monitorimet e kryera nga KShH evidentojnë nevojën për zhvillimin e një game më të gjerë aktivitetesh edukuese, sportive dhe rehabilituese, përfshirë edhe garantimin e takimeve me familjarët pa cënuar thelbin e kësaj të drejte nëpërmjet përgjimit apo mungesës së kontaktit fizik, parandalimin e diskriminimit të të burgosurve dhe paraburgosurve sidomos atyre që i përkasin komunitetit LGBT dhe atij Rom, etj.

Gjithashtu është konstatuar se të dënuarit/paraburgosurit vendosen në mjediset e veçimit ose të observimit jo në përputhje me kriteret e parashikuara në ligj apo në tejkalim të afateve të parashikuara. Një sërë ankesash janë drejtuar për krijimin e pengesave në përfitimin e lejeve shpërblyese për të dënuarit që plotësojnë kriteret ligjore. Këto problematika çenojnë jo vetëm të drejtat e personave të privuar nga liria por dëmtojnë gjithashtu procesin e rehabilitimit të tyre.

### *d) Shërbimi shëndetësor*

Nga monitorimet e kryera, KShH ka evidentuar disa problematika për shërbimin shëndetësor, një pjesë e të cilave janë të mbartura ndër vite. Konkretisht është vërejtur mungesë e medikamenteve, personelit mjekësor të kualifikuar, personelit kujdestar dhe sanitar, krijimi i vonesave ose mungesa e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat e privuar nga liria brenda dhe jashtë sistemit të burgjeve. Për këtë sistem vazhdon të mbetet sfida garantimi efektiv, profesional dhe i plotë i shërbimit shëndetësor nëpërmjet regjistrimit pa vonesa të të burgosurve në skemën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, sigurimi i një game më të gjerë të medikamenteve dhe pajisjeve mjekësore, si dhe plotësimin apo shtimin e organikës me staf të specializuar mjekësor sipas nevojave specifike.

Gjatë vitit 2016, është rritur në 175, numri i personave ndaj të cilëve gjykata ka vendosur pushimin e çështjes penale dhe dhënien e masës mjekësore “*Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor*”. Prej më shumë se dy dekadash, shumica e këtyre personave mbahen në kundërshtim me ligjin, në sistemin e burgjeve (në *IVSHB dhe I EVP Krujë*), ku nuk mund të marrin shërbimin shëndetësor të specializuar.

Pavarësisht se çështja është shtruar prej kohësh si një problem që kërkon zgjidhje urgjente, mungon një institucion i posaçëm, për këtë qëllim, siç përcakton ligji nr. 44/2012, “*Për shëndetin mendor*” dhe Kodi Penal. Kjo situatë krijon diskriminim dhe kushte për trajtim çnjerëzor e degradues për ata persona që mbahen në burgje, në kushte që nuk plotësojnë trajtimin e tyre sipas protokolleve përkatëse shëndetësore. Avokati i Popullit dhe organizatat e specializuara për të drejtat e njeriut kanë konstatuar të njëjtën problematikë në raportet e tyre.

Në muajin qershor 2016, KShH iu drejtua Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me ankesë për shkelje të të drejtave themelore të një shtetasi (A.S.), ndaj të cilit gjykata ka dhënë masën mjekësore “*Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor*”, i cili mbahet në kundërshtim me ligjin dhe nenin 3 të Konventës në sistemin e burgjeve. Kërkesa ju drejtua Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi më parë, gjykatat vendase nuk kishin gjetur një zgjidhje efektive për ankuesin dhe problematikën e adresuar.





# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

## *3.6.2 Respektimi i lirive dhe të drejtave të shtetasve nga strukturat e policisë dhe në pikat e kalim kufirit*

Ankesat e qytetarëve për ushtrim të dhunës fizike ose psiqike nga punonjësit e policisë kanë pësuar ulje, duke u përgjysmuar në krahasim me vitin e kaluar. Përkatësisht 3% e ankesave drejtuar KShH-së gjatë vitit 2016 kanë patur këtë objekt.

Një pjesë e ankesave i janë adresuar veprimeve arbitrare të Policisë Bashkiake të Tiranës ose pretendimeve për ushtrim dhune nga punonjësit e kësaj strukture, në kuadër të sekuestrimit të mjeteve motorike të përgjystruara që shërbejnë si mjet transporti për anëtarët e Komunitetit rom që punojnë si mbledhës individualë të mbetjeve urbane të riciklueshme.

Shqetësimet e ngritura në media apo organizata partnere të shoqërisë civile, si dhe ankesat e adresuara drejtpërdrejtë nga qytetarët kanë shërbyer si indicie për kryerjen e disa monitorimeve në Drejtorinë e Policisë së Tiranës, Komisariatit e Kurbinut dhe në Policinë Bashkiake të Tiranës.

Gjithashtu, KShH ka kryer disa vëzhgime në Pikat e Kalimit Kufitar gjatë vitit 2016, ku është konstatuar se kushtet e pritjes së refugjatëve dhe ato higjieno-sanitare janë përmirësuar ndjeshëm në krahasim me vitet e kaluara, por ende Shqipëria ka nevojë të rrisë kapacitetet akomoduese për të pritur emigrantët e parregullt dhe azilkërkuesit, kryesisht në afërsi të kufirit me Greqinë<sup>16</sup>.

KShH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila në të gjitha vizitat që kemi kryer ka bashkëpunuar dhe ka krijuar aksesin e nevojshëm për kryerjen e monitorimeve. Nga monitorimet e realizuara në mjediset e sigurisë së komisariateve të policisë, gjatë vitit të kaluar, rezultoi se dhomat ishin me hapësirë tepër të kufizuar, pa ndriçim të mjaftueshëm natyral, ose artificial, pa ajrosje, pa tualete të mjaftueshme e pa kushte higjienike të përshtatshme, me dyshekë të vjetër, të papastër, dhe në ndonjë rast, pa shtretër personalë, kushte të cilat kanë elementë dhe mund të çojnë në trajtim çnjerëzor ose poshtërues. Vlerësojmë se është e nevojshme kryerja e investimeve të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të kësaj infrastrukture.

Gjithashtu, në disa raste u konstatua shkelja e të drejtës për t'u informuar dhe për të marrë dëgjim rreth të drejtave që ligji parashikon për personat e shoqëruar, ndaluar ose të arrestuar në flagrancë në mjediset e policisë. Respektimi i të drejtave gjatë shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të personave, duke eliminuar çdo formë të ushtrimit të dhunës dhe keqtrajtim, mbetet sfidë e Policisë së Shtetit duke shfaqur nevojën për trajnimin dhe forcimin e vazhdueshëm të kapacitetit profesional dhe integritetit moral të punonjësve.

Pavarësisht përpjekjeve të strukturave të policisë për parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit, qytetarët kanë nevojë për më shumë siguri dhe mbrojtje efektive nga krimi, veçanërisht krimin të organizuar, kultivimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike, shpërdorimi i detyrës dhe korrupsioni nga zyrtarët publikë.

## **3.7 Barazia dhe ndalimi i diskriminimit**

<sup>16</sup> Komunikim i KE për Shqipërinë, 2016, fq. 85.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Barazia dhe ndalimi i diskriminimit është e drejtë themelore e parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës dhe nenin 14 të KEDNj-së.

Gjatë vitit 2016, organizatat e shoqërisë civile kanë qenë aktive duke vënë në lëvizje Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD-në), me kërkesa për konstatimin e diskriminimit në raste të evidentuara dhe vlerësuara gjatë veprimtarisë së tyre. Këto inisiativa janë ndërmarrë kryesisht nga organizata me fokus mbrojtjen e të drejtave të grave, të personave me aftësi të kufizuara si dhe mbrojtjen e të drejtave të komunitetit rom dhe egjiptian. Nevojitet një aktivizim më i lartë i organizatave që mbrojnë grupe të tjera vulnerabël që janë viktimë e diskriminimit të formave të ndryshme. Ndërkohë, i kemi sugjeruar në vazhdimësi Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të rrisë numrin e shqyrtimit të rasteve të diskriminimit me iniciativën e tij.

### 3.7.1 Diskriminimi për shkak të gjinisë

KShH vërejti se edhe gjatë vitit 2016 ka qenë shqetësuese gjendja e diskriminimit kundër grave dhe dhuna ndaj tyre.

Ndërkohë që përforcimi i politikave për barazi gjinore, në përgjithësi, ka avancuar, zbatimi i tyre mbetet sfidë. Me ndryshimet e vitit 2015 në Kodin Zgjedhor, është konstatuar përmirësim i pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje. Megjithatë, kërkohet një pjesëmarrje më e lartë e saj në pozicionet kyçe politike, në administratë publike dhe në sistemin gjyqësor.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për periudhën janar-shtator 2016, janë raportuar 3195 raste dhune në familje, duke shënuar rritje në krahasim me vitin 2015. Ndërsa në raportet e tij, Komisioni Evropian ka theksuar nevojën e përmirësimit në shërbimet për viktimat e dhunës familjare, në cilësi, sasi, akses dhe mbulim gjeografik. Dhuna me bazë gjinore ndaj gruas kërkon koordinim më të mirë mes organeve shtetërore dhe shërbimeve komunitare në të gjitha nivelet, në mënyrë që të rritet efikasiteti në luftën kundër saj.

KShH kreu një monitorim të 97 seancave gjyqësore penale dhe civile, me objekt “*Dhuna në Familje*”, “*Lëshim urdhër mbrojtje*” dhe “*Lëshim urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes*”, gjatë periudhës korrik-tetor 2016. Monitorimi ynë evidentoi se:

- 70 % e viktimave janë të gjinisë femërore;
- divorci, përdorimi i alkoolit, gjendja e rënduar ekonomike dhe konfliktet e pronësisë janë shkaqet kryesore të dhunës së ushtruar;
- dhuna ushtrohet fizikisht dhe psikologjikisht, në mënyrë sistematike për një kohë të gjatë;
- 37% e çështjeve janë pushuar për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse (gratë) që në seancën e parë, pasi vendosin të mos paraqiten ose deklarojnë se nuk ekziston më konflikti;
- në 40% të rasteve dhunuesi ka pasur arsim 8–9 vjeçar;
- *arrestimi në burg* dhe *detyrimi për paraqitje* janë masat e sigurimit që jepen më shpesh ndaj të pandehurve;
- dhunuesit rezultojnë recidivistë kryesisht për të njëjtën vepër penale;



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- në pjesën më të madhe të çështjeve penale procedohet me gjykim të shkurtuar, si dhe mungojnë masat parandaluese dhe mekanizmat mbrojtës efektivë, duke u trajtuar si një fenomen i zakonshëm;
- disa prej rasteve të dhunës në familje që janë përshkallëzuar me pasoja të rënda kanë evidentuar neglizhencë të policisë në fazën fillestare që viktimat paraqitet për të kërkuar pranë këtyre organeve (referuar dëshmitë gjatë gjykimit nga gra të dhunuara).

Referuar raporteve të KMD-së, vazhdon të mbetet problematik diskriminimi në punësim për shkak të shtatzanisë, lindjes, gjendjes shëndetësore ose marrëdhënies familjare, si nga institucionet publike ashtu edhe nga subjektet private. KShH ka trajtuar edhe ankesa të diskriminimit në marrëdhëniet e punës nga shtetase të gjinisë femërore, duke drejtuar kërkesë administrative për mundësinë e kthimit të përgjigjes dhe marrjen e vendimit brenda afateve ligjore, nga KMD-ja.

### 3.7.2 Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar

Personat me aftësi të kufizuar vazhdojnë të përballen me vështirësi në arsim, punësim, shëndetësi, shërbime sociale dhe pjesëmarrje e ulët në pozicione vendim-marrëse. Viti 2016 ka shënuar raste të keqtrajtimit ndaj këtyre shtetasve, për të cilat KShH ka reaguar, sikurse ishte rasti i publikuar në median investigative, ku mbaheshin me zinxhirë persona me probleme të shëndetit mendor në Qendrën e Zhvillimit Shkodër.

Kuadri ligjor për personat me aftësi të kufizuar vlerësohet në përputhje të pjesshme me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Në veçanti, neni 12 i Konventës, nuk është përshtatur ende në legjislacionin e brendshëm, duke zbehur çdo mundësi vendim-marrje të personit me aftësi të kufizuar të cilit i është caktuar një kujdestar ligjor. Konkretisht, ende nuk janë marrë masat e duhura legjislative në drejtim të garantimit të standarteve efikase dhe të përshtatshme për të parandaluar abuzimet e kujdestarit ligjor, me qëllim që të respektohet kapaciteti ligjor i personave me aftësi të kufizuar për të patur në pronësi dhe për të trashëguar prona, për të kontrolluar çështjet e tyre financiare dhe për të patur akses të barabartë në kreditë bankare, hipoteka apo forma të tjera të kredive financiare dhe të sigurohet që kësaj kategorie nuk i kufizohet në mënyrë arbitrare prona. Ligji i brendshëm duhet të parashikojë qartësisht se, përfaqësimi i interesave nga kujdestari ligjor duhet të respektojë maksimalisht të drejtat, vullnetin dhe preferencat e personave me aftësi të kufizuar.

KShH përshëndet miratimin e Planit të Veprimit për personat me aftësi të kufizuar 2016 – 2020. Bashkitë dhe ministritë e linjave duhet të emërojnë një zyrtar përgjegjës për çështjet e aftësive të kufizuara, siç parashikohet në nenin 14 të Ligjit Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

KShH ka trajtuar ankesat e shtetasve që kanë pretenduar diskriminim dhe veprime arbitrare për përfitimin e pagesave nga Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Ka patur raste që individë me invaliditet të përhershëm janë përjashtuar nga sistemi i pensioneve për shkak të paaftësisë për punë. Gjithashtu, prej disa muajsh KShH është duke ndjekur në rrugë ligjore rastin e një fëmije të mitur me aftësi të kufizuar në dëgjim dhe nevojën imediate për pajisjen me implantin koklear. Në vijim të rrugës administrative të adresimit për zgjidhje të çështjes, KShH ka ngritur padi në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe është në proces gjykimi, ndaj Ministrisë së Shëndetësisë, QSUT-së dhe Fondit për



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me palë të tretë Komisionerin për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit, me objekt konstatimin e diskriminimit për shkak të paaftësisë fizike të dëgjimit ndaj të miturit, ofrimin e shërbimit shëndetësor dhe vendosjen e implantit koklear, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj tij, me qëllim garantimin e së drejtës për trajtim të përshtatshëm shëndetësor dhe jetës së qetë private e familjare të shtetasve të prekur.

Vlen të përmendet se mungojnë të dhënat për zbatimin e masave me natyrë pozitive që synojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuar. Infrastruktura e institucioneve arsimore, shëndetësore, gjyqësore apo të administratës publike në përgjithësi nuk plotëson mjaftueshëm nevojat e këtij komuniteti për akses në shërbimet e ofruara.

Pavarësisht detyrimit të parashikuar në nenin 47, pika 2, gërma a), të Ligjit Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ofruesit e shërbimit mediatic Audioviziv (kombëtarë dhe lokalë) nuk kanë përparuar në garantiminim e përdorimit të gjuhës së shenjave për persona me aftësi të kufizuar në dëgjim.

### 3.7.3 Diskriminimi i minoriteteve

Ministria e Punëve të Jashtme ka ngritur një grup pune duke synuar hartimin e një ligji gjithëpërfshirës për mbrojtjen e minoriteteve. Kjo ministri ka realizuar disa procese konsultimi me përfshirjen edhe të shoqatave të minoriteteve, organizatave të shoqërisë civile dhe organizmave ndërkombëtarë. Disa prej këtyre komuniteteve kanë reaguuar për një zgjerim të karakteristikave mbi bazën e të cilave akordohet statusi i minoritetit, duke referuar në Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve.

10.7 % e ankesave drejtuar KShH-së vijnë nga shtetas që i përkasin minoriteteve apo komunitetit egjiptian. Ankuesit pretendojnë kryesisht cenim të së drejtës për jetë private dhe familjare dhe të drejtës për të mos u diskriminuar. KShH ka monitoruar në terren respektimin e të drejtës së jetës dhe shëndetit, arsimit, strehimit dhe punësimit të Komunitetit rom dhe egjiptian në bashkitë Tiranë, Durrës, Fier, Berat, Shkodër dhe Krujë. Nga misionet monitoruese ka rezultuar se:

- Shtetasit e kontaktuar nuk kanë informacionin minimal të nevojshëm për të drejtat dhe mjetet e kërkimit të tyre;
- Pavarësisht fushatave të vaksinimit nga Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik, një pjesë e fëmijëve ende nuk janë të vaksinuar;
- Mosndjekje e arsimit bazë të detyrueshëm nga një pjesë e fëmijëve të komunitetit;
- Shumica e personave të aftë për punë punojnë si mbledhës individualë të mbetjeve urbane të pasiguruar dhe në rrezik potencial për mungesën e kushteve higjienike;
- Mungon efektiviteti në ofrimin e kurseve profesionale dhe orientimit drejt tregut të punës së përshtatshme për ta;
- Mungon infrastruktura e kanalizimit të ujërave të zeza dhe ujit të pijshëm në zonat ku banojnë;
- Pranë banesave ekzistojnë në masë gropat septike, të cilat mund të përbëjnë rrezik për sëmundje infektive apo sëmundje të tjera të dëmshme për shëndetin;

Kushtet infrastrukurore të amortizuara brenda dhe jashtë banesave të banorëve rom dhe egjiptian kërkojnë adresim të çështjes nëpërmjet zbutjes së kritereve për përfitimin nga



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

programet e strehimit social dhe zbatimin e strategjisë nëpërmjet politikave të bashkërenduara të institucioneve qendrore dhe vendore përkatëse. Adresimit institucional të problematikave të konstatuara gjatë monitorimit të KShH-së, vetëm Ministria e Arsimit dhe e Sporteve iu përgjigj pozitivisht, duke u angazhuar për vëmendje të shtuar në drejtim të përmirësimit të situatës në fushën e arsimit të detyrueshëm.

Procesi i grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme, masivisht, nga antarë të Komunitetit rom dhe egjiptian është shoqëruar me ankesa të shumta nga këta shtetas ndaj Policisë Bashkiake Tiranë për sjellje diskriminuese, duke cënuar dinjitetin dhe shpesh integritetin fizik të tyre. Ofrimi në rrugë informale për punë në Landfillin e Sharrës për këta shtetas ka rezultuar i papërshtatshëm për shkak të kushteve jo të mira të punës, distancës së largët me vendbanimin e tyre dhe kostos së papërbalueshme për transportin, si dhe pagesa disa herë më të ulëta se në pika të tjera grumbullimi.

Në reagimin publik të dt. 10 gusht 2016 mbi ngjarjen tragjike ku një i mitur 17 vjeçar u gjend pa jetë në këtë landfill, ndër të tjera KShH rekomandoi që alternativat e punësimit që u ofrohen shtetasve të Komunitetit rom e egjiptian duhet të jenë të sigurta për jetën dhe shëndetin e tyre dhe t'i përgjigjen nevojave ekonomike të tyre dhe familjarëve të mitur apo të moshuar që kanë në ngarkim. Për këtë çështje, KShH iu drejtua edhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke kërkuar kryerjen e një hetimi administrativ *ex-officio* të këtij institucioni, nëse ndalimi i këtij aktiviteti individual për këta shtetas përbën qasje diskriminuese apo jo, duke marrë në konsideratë faktin se pasojat mund të jenë shumë të dëmshme pasi do të ndërpriste mundësinë e vetme për të siguruar të ardhura për këto familje dhe do të përkeqësonte jetën e përditshme të antarëve të këtij Komuniteti, të cilët jetojnë në kushte të mjerueshme. Madje shumica e tyre nuk kanë një strehë të sigurtë, pasi një numër i konsiderueshëm i familjeve të Minoritetit rom e Komunitetit egjiptian në zonën e Bregut të Lumit, Bashkia Tiranë u shpërngulën forcërisht nga baraket ku jetonin për shkak të punimeve në infrastrukturën publike, por pa garantuar efektivisht dhe në kohë programe strehimi të pranueshme dhe të përbalueshme për të gjithë të prekurit, duke cënuar thelbin e të drejtës për jetë të qetë private dhe familjare, për një pjesë prej tyre.

### 3.7.4 Diskriminimi i personave me orientim të ndryshëm seksual

Në fushën e të drejtave të personave lesbike, gay, biseksualë, transeksualë dhe ndërgjinorë (LGBTI), përbën hap pozitiv miratimi i planit të veprimit për të drejtat e kësaj kategorie shtetasish për periudhën 2016 – 2020. Vitet në vijim do të jenë deçizive në drejtim të vlerësimit të efikasitetit dhe vënies në zbatim të këtij plani, sa i takon ndërhyrjeve të parashikuara në disa nivele duke përfshirë zhvillimet legjislative, politikat, programimin dhe ofrimin e shërbimeve të standartizuara, trajnimin e stafeve profesionale dhe ofruesve të shërbimeve, si dhe të aktorëve që merren me edukimin/informimin dhe ndërgjegjësimin publik, me një fokus të veçantë tek OJF-të e LGBTI-ve dhe të të drejtave të njeriut.

Pavarësisht një sërë aktiviteteve sensibilizuese që janë zhvilluar gjatë vitit 2016, ndërgjegjësimi i publikut dhe pranimi në shoqëri i këtij komuniteti mbetet në nivele të ulëta. Gjithashtu, janë shënuar raste të sjelljeve diskriminuese nga punonjës të administratës publike ndaj antarëve të këtij komuniteti, gjatë ushtrimit të funksionit publik. Qendra “Streha” mbështetet tërësisht nga donacionet për të ofruar shërbime strehimi, ushqimi, veshmbathje, ndihmë psikologjike, etj ndaj antarëve të komunitetit LGBTI në nevojë.





# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Ndryshimet në kodin e familjes, për të prezantuar konceptin e bashkëjetesës së çifteve brenda të njëjtës gjini, ende nuk janë miratuar.

Gjatë vitit 2016, KShH ka adresuar disa ndërhyrje institucionale duke mundësuar edhe një takim në zyrat e saj ndërmjet anëtarëve të komunitetit LGBTI dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (*ShÇBA*) në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak të pretendimeve për sjellje diskriminuese dhe arbitrare të punonjësve të Policisë së Shtetit në Drejtorinë e Qarkut Shkodër. *ShÇBA*-ja konstatoi sjelljen e punonjësve të policisë në shkelje të etikës dhe standardeve profesionale.

### 3.7.5 Diskriminimi i të miturve

Gjatë vitit 2016, Ministria e Mirëqënies Sociale ndërmori nismën e hartimit të një ligji të ri për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, i cili synon ngritjen e një sistemi efektiv për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe forcimin e aftësisë reaguese të sistemit për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës. Gjatë hartimit të kësaj nisme nga kjo Ministri si dhe gjatë shqyrtimit në komisionet parlamentare të Kuvendit pati një konsultim të gjerë dhe debat gjithëpërfshirës me organizatat e shoqërisë civile. Në kuadër të Reformës në Drejtësi është ndërmarrë nisma për hartimin dhe konsultimin e një kodi të veçantë për të miturit në konflikt me ligjin. Për të dyja këto projektakte, KShH ka kontribuar aktivisht me oponencë ligjore për përmirësimin e cilësisë së dispozitave dhe standarteve të të drejtave të fëmijëve.

Media, në mënyrë të veçantë ajo investigative ka referuar raste të dhunës fizike dhe psikologjike të mësuesve ndaj fëmijëve që frekuentojnë sistemin parashkollor dhe ciklin e ulët. Ka patur raste edhe të abuzimeve tepër flagrante ndaj këtyre fëmijëve që kanë tronditur opinionin publik. KShH ka reguar publikisht duke evidentuar se kjo situatë është tregues i faktit se masat e marra nuk kanë qenë efikase në drejtim të parandalimit dhe goditjes së këtij fenomeni. Drejtuesit e shkollave apo të strukturave më të larta arsimore duhet të marrin masa të menjëhershme dhe të nevojshme për të parandaluar dhunën ndaj nxënësve në çdo formë që paraqitet ajo. Gjithashtu, problematikat e referuara nga organizata të ndryshme për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi, nuk rezultojnë të kenë gjetur gjithmonë zgjidhje efektive nga institucionet publike përkatëse.

Në “Studimin Kombëtar mbi prevalencën e aftësive të kufizuara të fëmijëve”<sup>17</sup>, të Save the Children, prezantuar në muajin dhjetor 2016, rezulton se në rreth një etalon prej 13,000 familjesh të intervistuar, 10 % e fëmijëve kanë pasur minimalisht 1 herë vështirësi në nivel të lartë të funksionimit apo zhvillimit të tyre, kryesisht për të parit, të dëgjuarit, të ecurit, të folurit, memorizimit, të kujdesit ndaj vetvetes, të komunikuarit, të mësuarit, vetëkontrollit, pranimin e dallimeve, ndërtimin e marrëdhënieve, përqëndrimin, të luajturit dhe socializimi në grup.

102 fëmijë të cilët jetojnë ose punojnë në rrugë dhe familjet e tyre janë marrë në mbrojtje, gjatë gjysmës së parë të vitit 2016. Shërbimet e ofruara për këto familje përfshijnë këshillimin, regjistrimin e fëmijëve në shkollë, kopshte dhe çerdhe, aplikimet për asistencë financiare dhe kujdesin shëndetësor. Gjithashtu, vazhdon të jetë prezente nevoja për përmirësimin e mekanizmave për mbledhjen e të dhënave dhe raportimit, si dhe koordinimi ndërsektorial.

---

<sup>17</sup> <https://albania.savethechildren.net/news/national-study-prevalence-disability-for-children>





# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Planifikimi, buxhetimi dhe riedukimi i përshtatshëm i të miturve në konflikt me ligjin vazhdon të jetë një çështje që nuk ka marrë vëmendjen dhe angazhimin e duhur prej politikëbërësve dhe institucioneve ligjzbatuese. KShH thekson rëndësinë e madhe që ka informimi dhe edukimi i fëmijëve dhe të rinjve mbi të drejtat e njeriut.

### 3.8 E drejta për t'u informuar

Pavarësisht progresit të shënuar në drejtim të zbatimit të ligjit të ri për të drejtën e informimit, organet publike shpesh herë nuk zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe nuk kanë një kuptim të drejtë të tij.

Gjatë 2016-ës, rreth 7% e ankesave drejtuar KShH-së kishin të bënin me shkeljen e të drejtës për t'u informuar, përkatësisht për mosdhënie përgjigje për kërkesë-ankesat e të dënuarve nga institucionet penitenciare, mungesë informacioni nga administrata e burgjeve për amnistinë/faljen, procedurat jo transparente nga organet e administratës publike qendrore dhe vendore, mungesë informacioni nga gjykatat apo nga prokuroria, veçanërisht me mungesën e informimit të pandehurve apo të dëmtuarve mbi ecurinë e hetimit, zgjatjen e afateve, etj.

Cenimi i të drejtës së informimit shpesh raportohet si një shkelje dytësore që shoqëron një shkelje tjetër të lidhur me të drejtat në sistemin e burgjeve, në sistemin gjyqësor, përfitimin nga shërbimet publike, etj.

KShH, në mungesë të një përgjigje zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë për mungesën e pajisjeve të dëgjimit për të miturit me aftësi të kufizuara dëgjimore, ju drejtua Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili nuk e pranoi ankesën tonë. Vendimi i Komisionerit u kundërshtua në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, e cila pranoi kërkesën e KShH-së duke i kërkuar Komisionerit hetimin administrativ të shkeljes së të drejtës së informimit nga Ministria e Shëndetësisë, duke shënuar njëkohësisht një shembull pozitiv për raste të ngjashme. Pavarësisht këtij precedenti, Komisioneri ka qenë tepër aktiv në trajtimin e ankesave të adresuara nga organizata e individë të ndryshëm, ku më së shumti është konstatuar shkelje e së drejtës së informimit.

Në komunikimin e saj për Shqipërinë gjatë 2016, Komisioni Evropian konstaton se nga vëzhgimet e kryera në 6-mujorin e parë qeverisja vendore tregojë e gatshme të jepte informacion sa i përket vendimmarrjes së këshillit bashkiak por më pak transparencë mbi çështjet financiare apo legjislativin.

### 3.9 E drejta për t'u konsultuar (pjesëmarrja e grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse)

Procesi i konsultimit me publikun mundëson që një numër i madh personash, përfaqësues të shoqërisë civile, biznesit, medias, botës akademike, publikut në përgjithësi si dhe institucioneve të kontribuojnë në përgatitjen e legjislativin, strategjive ose politikave me interes publik dhe krijon gjithashtu, mundësinë për t'u njohur me mendimet dhe sugjerimet e tyre nga organet publike që hartojnë këto projekte.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Gjatë vitit 2016, KShH ka monitoruar faqen e Kuvendit për procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik. Koordinatori për shoqërinë Civile i Kuvendit krijon mundësi për pjesëmarrjen e publikut në ndjekjen e seancave dëgjimore në Komisionet Parlamentare. Nga procesverbalet e mbledhjeve të këtyre Komisioneve nuk rezulton të ketë gjithmonë proces konsultimi publik me grupe interesi për projektligje të ndryshme. Edhe projektligjet që prekin të drejtat e njeriut jo gjithmonë konsultohen me organizatat që mbrojnë këto të drejta. Afatet e konsultimit shpesh herë janë të ngushta dhe nuk e bëjnë konsultimin efektiv por e shoqërojnë me nota formalizmi. Teksa grupet e interesit shprehin mendimin e tyre për tekstin e projektligjit që është në shqyrtim në Komisionet parlamentare, nuk i nënshtrohen procesit të konsultimit publik amendamentet e propozuara për projektligjin nga anëtarët e këtyre Komisioneve. Në shumicën e rasteve, diskutimi dhe shqyrtimi i këtyre amendamenteve bëhet pa debat dhe gjithpërfshirje të publikut apo grupeve të interesit.

Në tetor të vitit 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Në gjysmën e dytë të vitit 2016, KShH ndërmoi nismën për të rritur ndërgjegjësimin e grupeve të interesit për njohjen dhe zbatimin e këtij ligji si dhe për të monitoruar zbatimin e tij nga 19 ministri dhe Institucioni i Kryeministrit. Gjetjet paraprake evidentuan se nuk ka një kuptim të drejtë të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik. Procesi i njoftimit dhe konsultimit publik raportohet mbi bazën e traditës së vjetër dhe mungojnë indikatorët konkretë që hedhin dritë për mënyrën se si është zbatuar procedura ligjore e njoftimit dhe konsultimit publik. Regjistri elektronik ku duhet të publikohen të gjitha projektligjet, çka mundëson aksesin dhe dhënien e kontributit aktiv nga publiku, në fakt nuk u vu në funksionim të plotë gjatë vitit 2016. Nga ana tjetër, rezulton që presioni pozitiv që duhet të ushtrojnë grupet e interesit për të nxitur pjesëmarrjen e tyre në proceset konsultuese është në nivele tepër të ulëta. Kjo evidentohet qartë nga fakti se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk rezulton të jetë vënë në lëvizje bazuar specifikisht në ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik.

Gjatë vitit 2016 KShH ka dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e tij për një sërë projektligjesh, duke përfshirë paketën ligjore në kuadër të Reformës në Sistemin e Drejtësisë. Ndër të tjera, KShH ka kontribuar duke ofruar opionencë ligjore për projektligjin “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, “Për provimin e Shtetit për profesionin e juristit”, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Kodin Penal”, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, “Për shërbimin e provës”, “Për mbrojtjen e sinjalizuesve”, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, “Projektin e Standardeve Profesionale”, “Për nismën ligjvënëse popullore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ka dhënë mendime apo sugjerime konkrete lidhur me mënyrën e raportimit vjetor në Kuvend, të institucioneve kushtetuese apo ligjore, si Avokati i Popullit dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).

### 3.10 Respektimi i së drejtës për t’u organizuar dhe liria e tubimit

Viti 2016 ka shënuar organizimin e disa protestave dhe grevave urie të lokalizuara në zona të ndryshme të vendit, të cilat në përgjithësi janë administruar në mënyrë paqësore nga Policia e Shtetit.

Pavarësisht se nuk ka patur incidente me mbrojtësit e të drejtave të njeriut, vërehet se mjedisi në të cilin punojnë dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre shumë organizata jofitimprurëse në disa raste



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

synon të frenojë veprimtarinë e këtyre organizatave. Deklaratat apo reagimet e bëra në disa raste kundër organizatave të shoqërisë civile, ndikojnë në mënyrë të padrejtë në uljen e besimit të publikut në veprimtarinë e shoqërisë civile si dhe zhvendosin vëmendjen nga kauzat që mbrohen prej saj nëpërmjet protestave apo tubimeve paqësore.

Gjatë 2016-ës, KShH ka trajtuar një ankesë të banorëve të fshatit Potom, Bashkia Çorovodë me objekt pengim në ushtrimin e të drejtës së tubimit për dëmet e shkaktuara nga punimet për ndërtimin e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP). Nga verifikimi i shqetësimit, rezultoi se pretendimi ishte i pabazuar për shkak të tërheqjes së banorëve nga kërkesa për tubim. Gjithashtu, u vërejt se punonjësit e policisë në këtë zonë nuk kishin informacion mbi standardet ligjore të respektimit të kësaj të drejte.

Komisioni Evropian<sup>18</sup> vlerëson se, krahasuar me 2015 Shqipëria ka bërë pak progres për respektimin e së drejtës për tubim dhe organizim.

### 3.11 Mbrotja e mjedisit

Dëmtimi i pyjeve, si pasojë e prerjes së pemëve pa kriter, shfrytëzimi i inerteve të lumenjve, duke dëmtuar rrjedhën e tyre natyrore, hedhja e mbetjeve të ndërtimit buzë ujrave natyrore si lumenj e liqene, lëshimi i gazrave ndotës në ajër dhe veprime të tjera abuzive, kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në mjedis. Organet përgjegjëse të pushtetit publik, në nivel qendror dhe vendor nuk kanë mundur të reagojnë mjaftueshëm për t'i parandaluar këto veprime. Gjithashtu, organet e sistemit të drejtësisë penale nuk kanë qenë efektive në drejtim të vënies para përgjegjësisë penale të autorëve të veprave penale në fushën e mjedisit.

KShH ka realizuar dy misione verifikimi në fshatin Visokë, Bashkia Mallakastër dhe në fshatin Potom, Bashkia Çorovodë ku ka konstatuar respektivisht mungesë të ujit të pijshëm dhe ndotje apo mundësi reale të ndotjes së ujit të pusit, që shfrytëzohej nga banorët e fshatrave. Institucionet shtetërore nevojiten të ndërhyjnë urgjentisht për të garantuar parametrat e higjienës të burimeve ujore që përdoren nga banorët si alternative në mungesë të marrjes së shërbimit publik të furnizimit me ujë. Gjithashtu, është i nevojshëm garantimi i këtij shërbimi në zonat e populluara, duke investuar ndjeshëm në krijimin e infrastrukturës së nevojshme.

Grumbullimi dhe përpunimi me standarte i mbetjeve urbane larg zonave të banuara si dhe minimizimi i ndotjes së mjedisit nga veprimtaria industriale në Tiranë, Elbasan, Patos, etj, vazhdon të mbetet një nevojë që duhet të adresohet efektivisht nga institucionet shtetërore përgjegjëse, në konsultim të qëndrueshëm me ekspertë të fushës dhe popullatën në nivel vendor.

Së fundmi, KShH vlerëson se mbrotja e mjedisit nuk është vetëm detyrim pozitiv i shtetit por kërkon ndërgjegjësim dhe sensibilizim më të gjerë të shtetasve që të mos e dëmtojnë atë, por përkundrazi, të kontribuojnë për mbrojtjen e tij.

<sup>18</sup> Komunikimi i KE për Shqipërinë, 2016